



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE

Në përputhje me nenin 1 pika 1.3 paragrafi (ç) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh dispozitat e nenit 5 paragrafi 5.32 dhe 5.33 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe familjare,

Me qëllim të Sigurimit të kushteve për funksionimin e drejt dhe efikas të Këshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare,

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 02/2007
PËR
PËRCAKTIMIN E PAGESËS FINANCIARE NË FORMË HONORARIT PËR
ANËTARET E KESHILLIT PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit Administrativ

Përmes këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohen rregullat dhe procedurat e pagesave financiare në forme të honorarit – paushallit për anëtarët e Këshillit për Shërbime Sociale dhe familjare

Neni 2

Destinimi i pagesave financiare

Pagesat financiare mujore në forme të honorarit për anëtarët e Këshillit për Shërbimet Sociale dhe Familjare, do të bëhen më qëllim të qasjes dhe angazhimit të përkushtuar

permanent të anëtareve të Keshillit, në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara më Ligjin për shërbime sociale dhe familjare dhe me aktet tjera nënligjorë.

Neni 3

Lartësia e pagesave financiare

Në mandatin e ushtrimit të funksionit për Kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e Këshillit shuma e pagesave financiare për një muaj në formë honorari – paushall do të jete si ne vijim:

- Për Kryetarin e Keshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare80 €
- Për Zëvendëskryetarin e Keshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare70€
- Për anëtarët e tjerë të Keshillit për Shërbime sociale dhe familjare.....50€

Neni 4

Mënyrat e Kompensimit të Honorarit

Pagesat financiare mujore në formë të honorarit, anëtarët e Keshillit do ti realizojnë në mënyre retroaktive, nga 01.07.2006, date e cila ndërlidhet më themelimin e Keshillit për Shërbime Sociale dhe Familjare,

Neni 5

Ndalesat e pagesave financiare

Për mospjesëmarrje në seance të Keshillit, anëtarit i cili mungon do ti ndalet pagesa financiare e honorarit për muajin përkatës, gjate të cilit është mbajtur mbledhja e Keshillit.

Neni 6

Burimet e mjeteve financiare të pagesave

Honorari mujor për anëtarët e Keshillit do të paguhet nga mjetet financiare të Departamentit të Mirëqenies Sociale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale .

Neni 7

Zbatimi i Udhëzimit Administrativ

Për zbatimin e drejt dhe efikas të këtij Udhëzimi Administrativ do të përkujdeset, Drejtori ekzekutiv- financiar i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale .

Neni 8
Hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ

Ky Udhëzim Administrativ do të hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga 01.07.2006

Prishtinë, janar 2007

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj
